



VENDIM

Nr. 98, dt. 10.05.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 10.05.2016, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohen projektet:
 - Propozim për hapje porte në murin rrethues në banesën e Z.Agim Deliu K-001/b, lagjja “Kala”, Berat
 - Projekt restaurimi i çatisë së banesës kategoria e parë e Rexhep Lapit – Thimi Ziu sot Kristina Ziu T-04, Zona e Mbrojtur (Tampon), lagjja “28 Nëntori”, Berat.
 - Projekt restaurimi i çatisë së banesës kategoria e parë e Piro Angjeliut G-136, lagjja “Goricë”, Berat.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI